



Tiranë, më 27.06.2025

Parashtrime

Përpara: Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, trupit gjykues të përbërë nga Gjyqtari z. Astrit Kalaja

Palë e interesuar: z. Gjon Shkambi, i biri i Markut dhe Drande, lindur në Ndrejaj, Shkodër, i datëlindjes 28.04.1969, me ID G90428167J, banues në Shkodër, Lagja "Skënderbeg" nr. 3, Rruga "Bjeshka", mashkull, invalid, shtetësi dhe kombësi Shqiptar, i martuar, me dy fëmijë, me nr.kontakti cel 0682079977, email shkambigjon@gmail.com

Objekti: Parashtrimet e palës së interesuar për ankimin ndaj vendimit nr. 618 (3341), datë 11.07.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

I nderuar z. Gjyqtar,

Unë Gjon Shkambi, palë e interesuar në gjyqin me nr. çështjeje 21274-04385-30-2024, po paraqes parashtrimet e mia përse ky ankim duhet të pranohet.

I. Rrethanat e çështjes

Unë jam pronar i një objekti të quajtur "ish Shkolla e Rezervave", që gjendet në lagjen "Skënderbeg", Shkodër.

Ky objekt është ndërtuar nga shteti në tokën e trashëgimlënësit Binak Shkambi(Pjetra), pasi toka i është marrë me forcë nga regjimi komunist.

Pas rënies së komunizmit, familja Shkambi është njohur si pronare e truallit dhe, sipas ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, kemi gëzuar të drejtën e parablerjes së objektit.

Prej vitit 2012, unë jam pronar "de jure" i këtij objekti, të cilin ia kam blerë shtetit.

Për marrjen në posedim të pronës time, e cila vazhdon të jetë e zaptuar nga persona të tretë, unë i jam drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror për të ekzekutuar urdhrin e ekzekutimit nr. 20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër. Pas shqyrtimit të dokumenteve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror më është përgjigjur duke më udhëzuar që t'i drejtohem me një kërkesë Zyrës së Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror Shkodër, pasi kjo zyrë ishte kompetente për ekzekutimin e urdhrin të ekzekutimit.

Më datë 10.10.2022, Kryetari i Zyrës Përmbartimore, z. Tauland Muja, ka regjistruar urdhrin e ekzekutimit dhe ka filluar procedurat për ekzekutimin e tij.

Më datë 13.10.2022, Përmbartuesi Gjyqësor Shtetëror ka nisur shkresat "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" drejtuar personave të tretë që qëndrojnë forcërisht dhe në kundërshtim me ligjin në pronën time. Më pas, është kryer veprimi përmbartimor "kalim në ekzekutim të detyrueshëm". Zaptuesit i janë drejtuar gjykatës me kërkesa për sigurim padie dhe kundërshtim të veprimeve përmbartimore, të cilat janë rrëzuar e pushuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe kanë mbetur në fuqi edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Pas këtyre vendimeve, përmbaruesi ka vazhduar me procedurat.

Duke u mbështetur në nenin 606 të Kodit të Procedures Civile, më datë 03.10.2023, Zyra Përmbarimore Shkodër ka gjobitur shtetasit Ragip Kurtaj, Gjok Martini, Seladin Brankaj, Dukate Leka, Palë Rrethaj, Gjelosh Sufaj, Pashko Pepniku, Mark Colaj, Ndue Pllumbi, Ndoc Ndoci, Petrit Kerrçi, Mirash Pepaj dhe Mitër Thaçina.

Personat e gjobitur, të cilët vazhdojnë ta mbajnë pronën time forcërisht, i janë drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me “kërkesëpadi”, ku kanë kërkuar anulimin e gjobave përmbarimore, me nr. 116 dkp. prot. 3146-3159.

Në cilësinë e “personit të tretë” në këtë proces gjyqësor, unë kam paraqitur fakte e prova të mbështetura në ligj, dhe kam kërkuar rrëzimin e kërkesëpadisë.

Me vendim nr. 618 (3341), datë 11.07.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka vendosur pranimin e padisë dhe anulimin e gjobave përmbarimore. Brenda afatit ligjor, unë kam paraqitur ankimin e këtij vendimi në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe kam kërkuar:

Ndryshimin e vendimit nr. 618 (3341), datë 11.07.2024;

Lënien në fuqi të gjobave përmbarimore me nr. 116 dkp prot. 3146-3159.

II. Bazueshmëria në prova dhe ligj e ankimit

Duke u mbështetur në nenin 510 e në vijim të Kodit të Procedures Civile, unë i jam drejtuar me kërkesë Zyrës Përmbarimore Shkodër për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit nr. 20, datë 28.06.2010, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Zyra Përmbarimore Shkodër nuk ka ndeshur në asnjë pengesë ligjore gjatë regjistrimit dhe ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit.

Neni 610 i Kodit të Procedures Civile, parashikon:

“Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit ose refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur, dhe, në raste të tjera, nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin.

...Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbaruesin gjyqësor.

Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe...”

Neni 609 i Kodit të Procedures Civile parashikon:

“Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas. Afati për të paraqitur këtë kërkesëpadi është 30 ditë nga marrja dijeni për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm.”

Personat që mbajnë forcërisht pronën time kanë kundërshtuar veprimet përmbarimore në Gjykatë, si dhe kanë kërkuar “pavlefshmëri të titullit ekzekutiv”, madje edhe kanë pretenduar se ka një vendim të tillë, por kërkesëpaditë/ankimet janë rrëzuar e pushuar nga 3 gjyqtarë të ndryshëm në dy shkallë të gjyqësorit.

Në vendimin me nr. 784(4921), datë 24.11.2022, që lidhet me kundërshtimin e veprimeve përmbarimore nga ana e shtetasve Gjelosh Sufaj, Ndoc Ndoci dhe Ndue Pllumbi (palë paditëse

në gjyqin për anulimin e gjobave përmbartimore), Gjykata shprehet në lidhje me 3 pika kryesore: në lidhje me veprimet përmbartimore, detyrimin e personave të tretë dhe vlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Gjykata, ndër të tjera, thekson: a) *“...në lidhje me pretendimin e paditësve se nuk ka asnjë vendim gjyqësor që të ketë përcaktuar detyrime për ata, për shkak se vendimet gjyqësore të vëna në ekzekutim kanë palë: kreditor Gjon Shkambi dhe debitor KKKP Bashkia Shkodër, Gjykata vlerëson që ky qëndrim është terësisht i gabuar.”*; b) *“...paditësit janë posedues të paligjshëm të pasurive, të cilët krahas të tjerash rezultojnë t'i mbajnë këto pasuri me dhunë apo forcë. Kjo formë e posedimit të pasurisë nuk gëzon asnjë mbrojtje ligjore, aq më pak përkundrejt pretendimeve të pronarit të pasurisë”*; c) *“Përfundimisht Gjykata nuk konstaton veprime të kryera në kundërshtim me parashikimet ligjore nga ana e përmbartuesit gjyqësor dhe po kështu çmon se titulli ekzekutiv i vënë në ekzekutim përmes veprimeve të përmbartuesit gjyqësor nuk është i pavlefshëm. Mbi këtë shkak çmohet se kërkesëpadia objekt gjykimi duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe prova.”*

Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 30.01.2023.

Po shtetasit Ndoc Ndoci dhe Ndue Pllumbi janë rrëzuar sërish nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, vendim që është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me vendim nr. 432, datë 16.06.2023, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka lënë në fuqi vendimin 154(1455), datë 27.03.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, duke rrëzuar sërish pretendimet e shtetasve të lartpërmendur. Në një pjesë të këtij vendimi, Gjykata shprehet se veprimi përmbartimor i Zyrës Përmbartimore Shkodër është efektivisht një veprim i ri, pra nuk lidhet me asnjë vendim të mëparshëm që ka të bëjë me vlefshmërinë apo jo të veprimeve përmbartimore.

Ndër të tjera, në këtë vendim, theksohet:

“...titulli ekzekutiv është burim i menjëhershëm dhe i drejtëpërdrejt i legjitimitetit të kreditorit për të iniciuar procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, pasi ai që ka titullin ekzekutiv ka edhe të drejtën e përfshirë në të.”

Pavarësisht këtyre vendimeve, po këta persona kanë ngritur po të njëjtat pretendime kur kanë bërë kërkesëpadi për anulimin e gjobave përmbartimore, në një kohë kur mund të ankimohet vetëm veprimi përmbartimor nga ana procedurale, si: masa e ndëshkimit dhe procedura e ndjekur deri te masa ndëshkimore.

Me vendim nr. 157 (1458), datë 27.03.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka pushuar gjykimin e çështjes me paditës shtetasit: Mitër Thaçina, Dukate Leka, Gjok Martini, Suzana Vjerdha, Pashko Pepniku, Seladin Brankaj, Ragip Kurtaj, Mirash Pepaj, Sokol Lepeja dhe Pal Rrethaj.

Gjykata, për marrjen e këtij vendimi, mbështetet në nenin 299 të Kodit të Procedures Civile, konkretisht:

“Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur:

c) gjykata konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si dhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte. Kur këto shkaqe konstatohen nga gjykatat më të larta, ato prishin vendimin e gjykatave më të ulëta dhe vendosin pushimin e gjykimit...”

Në rastin konkret, kanë munguar kushtet themelore të padisë:

a. Legjitimiteti formal dhe interesi për të ngritur padi;

b. E drejta që pretendohet të mbrohet nga vendimi i gjykatës nuk është parashikuar në një normë të së drejtës.

Me të drejtë, Gjykata u është referuar vendimeve:

nr. 5, datë 03.03.2021, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 44, datë 16.01.2018, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nr. 262, datë 22.05.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

-Në vendimin nr. 00-2022-443(88), datë 17.03.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mbi *"Legjitimimi procedural dhe legjitimimi substancial në kundërshtimin e veprimeve përmbartimore dhe padia e kërimit të sendit nga personi i tretë"*, theksohet:

"...parakushtet procedurale të padisë janë kushte për krijimin e marrëdhënies procedurale, mungesa e tyre nuk pengon iniciimin e procesit, por përbën pengesë për shqyrtimin e themelit të çështjes. Mungesa e legjitimitetit procedural (formal) passjell pushimin e gjykimit të padisë..."

Referuar edhe këtij vendimi unifikues, personat që mbajnë forcërisht pronën time nuk legjitimohen për të kërkuar pavlefshmëri të titullit ekzekutiv, as për të kundërshtuar veprimet përmbartimore, por mund të mbështeten në nenin 612 të Kodit të Procedures Civile për të bërë padi për kërkimin e sendit.

-Në lidhje me padinë që mbështetet në nenin 612 të Kodit të Procedures Civile, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin me nr. 202, datë 30.05.2022, shprehet:

"Padia bazuar në nenin 612 të KPC është një prej rasteve specifike të kundërshtimit të veprimeve të përmbartuesit dhe konkretisht, kundërshtimi i veprimeve të këtij të fundit prej personave të tretë. Kjo padi ngrihet kundër debitorit dhe kreditorit dhe në gjykimin e kësaj padie, sqarimi i titullit të pronësisë ka vlerë thelbësore. Personi i tretë që kundërshton ekzekutimin, që të legjitimohet në këtë lloj padie, duhet të provojë se është pronar mbi sendin me anë të fitimit me titull origjinal apo të prejardhur. Pra në thelb, gjykata në shqyrtimin e kësaj lloj padie investohet në shqyrtimin e vlefshmërisë së titujve të pronësisë, që kanë palët ndërgjyqëse me pretendime pronësie mbi sendin, konkludon për përjashtimin e sendit nga ekzekutimi, gjykata de jure i njeh dhe konfirmon titullin e pronësisë palës paditëse, titull i cili duke iu kundërvënë titullit të pronësisë së palës të paditur e detyron palën e paditur që në fund të njohë pronësinë e paditësit mbi sendin."

Neni 612 i Kodit të Procedures Civile, parashikon:

"Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja. Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci."

Referuar këtij neni, personat që mbajnë forcërisht pronën time kanë patur mundësinë të pretendojnë pronësinë mbi pasurinë time, gjë që nuk ka ndodhur, pasi ata nuk kanë asnjë titull pronësie, por janë posedues të paligjshëm të pasurisë. Siç është shprehur edhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në vendimin 784(4921), datë 24.11.2022, marrë formë të prerë më 30.01.2023, **posedimi i tillë nuk gëzon asnjë mbrojtje ligjore.**

Për personat që mbajnë forcërisht pronën time, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendim nr. 105, datë 27.03.2002, shprehet se objekti që është aktualisht në pronësinë time (de jure), **është kthyer në shtëpi banimi pa leje dhe është i zënë forcërisht.**

Këta individë nuk janë pronarë asnjë të truallit, as të objektit. Ata nuk kanë pretenduar ndonjëherë pronësinë mbi objektin. Kur u është përshtatur, janë sjellë si debitorë, kurse në raste të tjera si posedues të paligjshëm që nuk kanë asnjë lidhje me Bashkinë Shkodër, as me

Shqipërinë, duke pretenduar në mënyrë të palogjikshme dhe të paligjshme që të filloj një proces gjyqësor me ta. E gjithë kjo ndodh, sepse ata janë në dijeni për situatën e vështirë ekonomike në të cilën ndodhem, ku borxhet rriten përditë, dhe kështu synojnë shkatërrimin tim e të familjes time.

Vendimi për njohjen dhe kthimin e pronës në fjalë është marrë duke u mbështetur në vendimet e gjykatave që datojnë që në vitin 1993, dhe në ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993. Ky ligj është bërë për ish pronarët dhe ka mbrojtur të drejtat e tyre. Çdo interpretim tjetër që i bëhet vendimeve të gjykatës dhe urdhrit të ekzekutimit, është joligjor dhe keqdashës.

Në vendimin me nr. 618 (3341), datë 11.07.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk ka treguar as minimumin e integritetit moral, as profesional, duke marrë një vendim tërësisht të pabazuar në ligj e fakte.

Në fillim të arsyetimit, Gjykata shprehet se objekt i gjykimit është mënyra dhe ligjshmëria e zhvillimit të procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

Më tej, **Gjykata shprehet se janë paditësit ata që duhet të provojnë se veprimet apo mosveprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor kanë cenuar të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme.** Pas kësaj pjese të arsyetimit, në dukje objektive dhe profesionale, Gjykata, papritur, fillon të bëjë interpretimin e titullit ekzekutiv.

Ndonëse më heret Gjykata u shpreh se paditësit duhet të provonin se veprimet e përmbaruesit cenonin interesat e tyre të ligjshme, ajo dështoi të identifikonte këto të drejta. Në asnjë moment, Gjykata, pavarësisht se konstatoi faktin se paditësit (të cilët, sipas ligjit duhet të ishin “ankues”) ishin “zaptues”, nuk përmendi ndonjë nen, apo ligj të veçantë që mbron personat që mbajnë forcërisht pronën e dikujt tjetër.

Gjykata shton se vendimet e gjykatës në favorin tim janë “deklarative” dhe “njohëse”, duke harruar që për to është lëshuar një urdhër ekzekutimi, i cili mban një të drejtë të përfshirë në të. Gjykata ka pranuar si provë të pakundërshtueshme “pohimin gjyqësor” të paditësve, të cilët, sipas saj, janë vendosur që në vitin 1993 në objektin që është në pronësinë time, gjë që është e pavërtetë dhe lehtësisht e provueshme për personat e gjobitur: Pal Rrethaj, Pashko Pepniku, Gjelo Shufaj dhe Mirash Pepaj.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka injoruar krejtësisht vendimet e formës së prerë, të cilat kanë lënë në fuqi veprimet përmbarimore të Zyrës Përmbarimore Shkodër. Kështu, me vendimin nr. 618 (3341), datë 11.07.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka synuar zhvlerësimin e të paktën 5 vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, gjë që e bën këtë vendim të pashoq, pasi një vendim gjykate ndryshohet vetëm nga një gjykatë më e lartë.

Më heret, Zyra Përmbarimore Shkodër më kishte dorëzuar dy banesa, përkatësisht më datë 20.06.2023 dhe 29.06.2023, banesa të cilat kanë qenë në posedimin e paligjshëm të shtetasve Mark Colaj dhe Fran Mema.

Vendimi i Gjykatës përmendur më sipër është dhënë me qëllim intimidimin e Kryetarit të Zyrës Përmbarimore Shkodër, pasi, nëse dorëzimi i banesave do të ishte bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe vendimet e gjykatës, siç nënkuptohet në këtë vendim, ai do të mbahej përgjegjës para ligjit. Ky vendim skandaloz, i gërrshetur me forma të ndryshme presioni, do të sillte më vonë pezullimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit.

Vlen të theksohet se të njëjtat pretendime që janë shtruar nga personat e gjobitur që mbajnë forcërisht pronën time në këtë proces gjyqësor, janë shtruar edhe nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër në gjyqin e kundërshtimit të gjobës përmbarimore.

Me vendim nr. 1217, datë 16.04.2025, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur "*rrëzimin e padisë, si të pabazuar në ligj e prova*", duke lënë në fuqi gjobën e vënë nga Zyra Përmbartimore Shkodër ndaj Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër për "*pengim të ekzekutimit të vendimeve të gjykatës*".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ndryshe nga sa ka bërë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i është përmbajtur objektit të padisë dhe ka dhënë vendimin e saj duke u bazuar në ligj e prova.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka gabuar rëndë në marrjen e këtij vendimi (nr.618, datë 11.07.2024), pasi ka dalë nga objekti i padisë, edhe pse ligjvënësi e ka përcaktuar qartë se në këtë fazë të ekzekutimit nuk diskutohet më në lidhje me titullin ekzekutiv, por vetëm mbi procedurën e ndjekur për veprimin përmbartimor të radhës, në rastin konkret të gjobës përmbartimore.

Sa i përket kësaj pike, e cila është thelbësore për çështjen, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është shprehur: "**...pala e paditur ka proceduar konform ligjit...**".

Mbështetur në ligj, prova e fakte, vërtetohet plotësisht se vendimi nr. 618 (3341), datë 11.07.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit dhe e shkeljeve të rënda, ndaj, si i tillë, duhet ndryshuar.

Përfundimisht, **kërkoj:**

-Ndryshimin e vendimit nr. 618 (3341), datë 11.07.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;

-Lënien në fuqi të veprimeve përmbartimore "gjobë" ndaj personave paditës në atë proces gjyqësor;

-Gjobitjen e palës paditëse Ragip Kurtaj etj. edhe për "*abuzim me të drejtat në proces*", sipas parashikimit të nenit 34/1 të Kodit të Procedures Civile.

Pala e interesuar,

Gjon Shkambi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR SHKODER
L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko Tel & Fax 00355 22 43591

Nr.Regj.Them. 84/1620

Nr.Vendimi 119

V E N D I M

"NE EMER TE REPUBLIKES"

Trupi gjykues i perbere nga:

Valbona DURRAJ – GJYQTARE

E me sekretare Manjola TRUNGAJ, sot me dt.11.02.2002, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen civile qe i perket:

- PADITES:** Mark Shkambi, i dtl.1938, banues ne L."Skenderbej", Rr."Marsel Kashen", Shkoder, perfaqesuar nga Gjon Shkambi.
- IPADITUR:** Komisioni i K.K.Pronave, prane Bashkise Shkoder, perfaqesuar nga Brikena Mjeda.
- OBJEKTI:** Ndryshimin e pjesshem te vendimit te K.K.K.Pronave nr.1158 dt. 5.07.1996.
- B. LIGJORE:** Ligji 7698 dt.15.04.1993 dhe udhezimi nr.3 dt.21.06.1993 te K.Ministrave.

V E R E N

Paditesi i eshte drejtuar Gjykates per ndryshimin e pjesshem te vendimit te K.K.K.Pronave nr.1158 dt.5.07.1996, pikerisht ne piken 1 te tij.

Gjate shqyrtimit gjyqesor rezultoi se me vendimin Nr.1158 dt.5.07.1996 ne mes te tjerave trashegimtareve ligjore te Binak dhe Syke Shkambi i eshte njohur per efekt te nenit 16 ose 21 sip. prej 4053 m², e zene sip. prej 1307 m² nga 4 objekte dhe sip. prej 2749 m² eshte territori i ketyre objekteve te shkolles Rezervave dhe konvikteve.

Paditesi kerkoi qe te saktesohen nenet e trajtuar nga ky komision si dhe fakti qe nje pjese e tokes eshte e lire e cila duhet te kthehet.

Nga ana e Gjykates u be akti i ekspertimit i cili konkludoi se sip. total eshte 4053 m² nga te cilat objekte te privatizuara jane objektet nr. 8 me sip. ndertimore 402 m², objekti nr.9 me sip.48 m², objekti nr. 10 me sip.335 m² dhe sheshi funksional i tij 1448 m², qe jane ngjyrosur ne skice me ngjyre te verdhe.

Objekti nr.11 me sip. ndertimore 522 m² dhe sheshi funksional 769 m² i paprivatizuar, shenuar me ngjyre jeshile, ndersa sip. e lire eshte 529 m² me ngjyre te kuqe. E pyetur nga Gjykata, ekspertja argumentoi se kjo pjese ekziston e lire, pasi objekti nr.11, ish-shkolla e Rezervave, sot e ka humbur destinacionin e saj, pasi ne te

jetojne disa familje duke e kthyer keshtu ne shtepi banimi dhe sheshi funksional i lene kesaj godine eshte i mjaftueshem.

Perfundimisht, Gjykata vendosi pranimin e kerkeses duke bere saktesimin te baza ligjore, ne piken 1te vendimit nr.1158 dt.5.07.1996, prandaj

PER KETO ARSYE

Gjykata, konform nenit 126 K.Pr.Civile


VENDOSI

1. Pranimin e kerkese-padise.
2. Saktesimin e pikes 1 te vendimit nr.1158 dt.5.07.1996 te K.K.K.Pronave si me poshte: Ne zbatim te nenit 16 i njihet ne pronesi siperfaqja prej 2233m² (e zene me objekte te privatizuara), sip.1291 m² e zene me godinen nr.11 ish-shkolla e Rezerves (sot i kthyer ne shtepi banimi) i njihet ne pronesi per efekt te nenit 21 me te drejte parablerjeje, ndersa sip.529 m² e kufizuar: veri-prona e Mark Shkembrit, jug-prona e Tom Ndokes, perendim-rruga Nacionale, lindje-prone e Mark Shkembrit, i kthehet per efekt te nenit 4 e 5 si siperfaqe e lire.
3. Siperfaqja total e trajtuar eshte 4053 m².
4. Lejohet ankim brenda afatit ligjor.

Shkoder me 11.02.2002.

Sekretare seance

Manjola TRUNGAJ



GJYQTARE

Valbona DURRAJ




Vertetohet se vendimi ka marre forme te prere

me daten 26.02.2002

Kryesekretari i Gjykates

Behar



Tafa



Kancelare

Elka

Dajçi





REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR SHKODER
L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko Tel & Fax 00355 22 43591

Nr.Regj.Them. 105

Nr.Vendimi 105

V E N D I M

"MBI NDREQJEN E GABIMIT"

Trupi gjykues i perbere nga:

Valbona DURRAJ – GJYQTARE

E me sekretare Manjola TRUNGAJ, sot me dt.27.03.2002, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen civile qe i perket:

PADITES: Mark Shkembj, i biri i Gjergjit, i dtl.1938, banues ne L.
"Skenderbeg", Rr."Marsel Kashen", Shkoder.

I PADITUR: Komisioni i K.K.Pronave, ne mungese.

OBJEKTI: Ndreqjen e gabimit te vendimit gjyqesor nr.119 dt.11.02.2002.

B. LIGJORE: Neni 312 K.Pr.Civile.

V E R E N

Paditesi i eshte drejtuar Gjykates me kerkese per ndreqjen e gabimit te vendimit civil nr.119 dt.11.02.2002 me arsyetimin se: ne dispozitivin e vendimit, Gjykata eshte shprehur "...ne zbatim te nenit 16 i njihet ne pronesi sip. prej 2233m² (e zene me objekte te privatizuara), sip.1291m² e zene me godinen nr.11, ish-shkolla e Rezervave (sot e kthyer ne shtepi banimi), i njihet ne pronesi per efekt te nenit 21, etj...". Pra shprehja "...sot e kthyer ne shtepi banimi" nuk duhet te ishte ne dispozitivin e Gjykates, pasi ato jane pa leje dhe jane zaptuar forcerisht.

Gjykata arsyeton se kerkesa eshte e drejte dhe se nje fakt i tille eshte provuar gjate shqyrtimit gjyqesor se banesat jane pa leje dhe te zoteruara forcerisht dhe vendos pranimin e kerkeses duke bere riparimin e shprehjes me " sot te kthyer ne shtepi banimi pa leje e te zena forcerisht" dhe prandaj

P E R K E T O A R S Y E

Gjykata, konform nenit 312 K.Pr.Civile.

V E N D O S I



1. Ndreqjen e gabimit te vendimit civil nr.119 dt.11.02.2002, ku shprehja ne kllapa nga (sot i kthyer ne shtepi banimi) behet (sot te kthyer ne shtepi banimi pa leje e te zena forcerisht).

- Pjesa tjeter e dispozitivit te vendimit mbetet ashtu siç ka qene.
2. Lejohet ankim brenda afatit ligjor;
Per K.K.K.Pronave afati fillon nga marrja dijani.

Shkoder me 27.03.2002.

Sekretare seance

Manjola TRUNGAJ



GJYQTARE


Valbona DURRAJ



**Vertetohet se vendimi ka marre forme te prere
sot me daten 03.04.2002**


Kryesekretari i Gjykates

Behar TAFA



Kancelare

Elka DAJCI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT SHKODËR

Nr.regj.them.38
(11233-00415-50-2010)
Data 17.06.2010

Nr.Vendimi.20
Data 28.06.2010

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Apelit Shkodër e përbëre prej gjyqtarëve:

MUSA HALILI KRYESUES

LUAN DERVISHI ANËTAR

FUAT VJERDHA ANËTAR

Asistuar prej sekretares, Valbona Kalci, ne datën **28.06.2010**, ne Shkodër, shqyrtoi në Apel ne seancë gjyqësore publike çështjen civile qe i përket:

KËRKUES: *Mark Shkëmbi*, i biri i Gjergj dhe i Lenës ,i datëlindjes 20.01.1935,banues në Shkodër.

OBJEKTI: Kërkohet lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për vendimin civil të formës së prerë me nr 119 datë.11.02.2002,dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësore Shkodër.

BAZA LIGJORE: Neni 510/a dhe 511 të K.Pr.Civile.

***Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin Nr.226
Datë.02.06.2010 ka vendosur:***

Rrëzimin e kërkeses.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.



Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuar Mark Shkëmbi ,me anë të së cilit ka kërkuar pranimin e kërkesës,duke përcaktuar këto shkaqe:

- Gjykata ka gabuar në arsyetimin e saj se vendimi gjyqësor që ndryshon një vendim të dhënë nga K.K.K.Pr ish pronarëve është vendim njohje .
- Ne jemi në proces privatizimi pikërisht sipas vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Trupi gjykues i gjykatës se Apelit Shkodër , pasi degjoi relacionin e gjyqtarit Musa Halili, degjoi ,kërkuesin që kërkont pranimin e kërkesës sipas objektit të saj,dhe pasi analizoit në tërësi çështjen

VËREN

Vendimi i gjykatës duhet të priset dhe çështja të gjykohet në fakt mbasi është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit.

Rezulton se kërkuar Mark Shkëmbi ka kërkuar nga Gjykata e rrethit lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.119 datë 11.02.2002 të dhënë nga e njëjta gjykatë.

Gjykata duke keqinterpretuar kërkesat e nenit 510/1 të K.Pr.civile ka rrëzuar kërkesën me arsyetimin se kërkuar i është njohur një e drejtë ajo e parablerjes dhe se ky vendim nuk përbën titull ekzekutiv që përmban një detyrim .

~~Ky arsyetim i gjykatës vjen haptazi në kundërshtim me kërkesat e nenit 150/1 K.Pr.Civile sepse sipas paragrafit të parë dhe, gërmës "a" të kesaj dispozite, vendimi i formës së prerë i gjykatës është titull ekzekutiv dhe lëshimi i urdhërit të ekzekutimit të tij është i detyrueshëm .~~

Ky detyrim buron e gjen mbështetje në gjermën "a" të nenit 115 të K.Pr.Civile.

Po kështu rezulton se vendimi nr 119 datë 11.02.2002 i gjykatës nuk është blanket por përmban detyrime për palët pjesëmarrëse në proces të gjykuar me cilësinë e paditësit ,që në këtë rast është kërkuesi dhe si e paditur K.K.Pronave pranë Bashkisë Shkodër.

Nga dispozitivi i këtij vendimi rezulton se është ndryshuar pika 1 e vendimit 1158 datë 5.07.1996 të K.K.Pronave e thirrur në këtë proces si palë e paditur.

Në këto rrethana për Kom.K.K.Pronave pranë Bashkisë ka lindur detyrimi për të mos zbatuar vendimin e dhënë nga ky komision por është i detyruar të zbatojë dispozitivin e vendimit të gjykatës në të kundërt do të rrëzohej padia e ngritur nga paditësi.

Përderisa vendimi i gjykatës i ka bërë ndryshime vendimit të K.K.Pronave pranë Bashkisë Shkodër duhet lëshuar urdhër për ekzekutimin e këtij vendimi.

Arsyetimi i gjykatës se ky vendim nuk përmban detyrim për palët por kërkuesit i është njohur një e drejtë e për rrjedhojë s'mund të lëshohet urdhër për ekzekutimin e tij është keqinterpretim i ligjit jo vetëm për faktin se dispozita nuk kërkon detyrim por dhe sikur ti jetë njohur kërkuesit një e drejtë ajo realizohet nëpërmjet një urdhër ekzekutimi siç është drejta e parablerjes .Në se në fazën e ekzekutimit do tu lindin palëve probleme në lidhje me detyrimet ndaj njëra tjetrës sejcila palë mund të kërkojë në rrugë gjyqësore zbatimin e të drejtave apo detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e atij vendimi i cili ka ndryshuar sipërfaqen e objekteve,ka përcaktuar kufizimet e pronësisë etj.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji civil i Gjykatës së Apelit Shkodër,në mbështetje të nenit 466 /b të K.Pr.Civile


VENDOSI

Ndryshimin e vendimit nr 226 datë 02.06.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.


Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të vendimit nr 119 datë 11.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Shkodër më 28.06.2010.


**ANËTAR
FUAT VJERDHA**



**ANËTAR
LUAN DERVISHI**




**KRYESUES
MUSA HALILI**



R/Sekretore

Arbion Shkëmbi




Shënim: Gently. Te arkivo

04.10.2015

Nepunë pjesë

Udhëheqës





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

Nr.Regj.Them 1771 (02304)
Dt.Regjistrimit 24.10.2022

Nr.Vendimi 784 (4921)
Dt vendimit 24.11.2022

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e përbërë nga:

Andri Ymeri – Gjyqtar

Me sekretare të seancës Mirsada Kastrati, sot me datën 24.11.2022 përfundoi së shqyrtuari në seancën gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile që i përket palëve të mëposhtme:

PADITËS:

Gjelosh Sufaj, i biri i Tom dhe i File, i datëlindjes 10.09.1945, banues në Shkodër, Rr. "Nënë Tereza" Ish Shkolla e Rezervave të Punës, përfaqësuar nga av. Artan Lika.

Ndue Pëllumbi, i biri i Mirash dhe i Lule, i datëlindjes 03.02.1964, banues në Shkodër, Rr. "Nënë Tereza" Ish Shkolla e Rezervave të Punës, përfaqësuar nga av. Artan Lika.

Ndoc Ndoci, i biri i Martin dhe i Line, i datëlindjes 24.05.1957, banues në Shkodër, Rr. "Nënë Tereza" Ish Shkolla e Rezervave të Punës, përfaqësuar nga av. Artan Lika.

TË PADITUR:

Zyra e Përmbarrimit Shkodër, përfaqësuar nga Taulant Muja.

Gjon Shkambi, i biri i Mark, i datëlindjes 13.04.1969, lindur në Ndrejaj Shosh e banues në Shkodër, L. "Skëndërbeg" Rr. "Nënë Tereza" nr 1027, përfaqësuar nga av. Elvis Alivoda.

OBJEKTI:

Kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore të vendimit për ekzekutimin vullnetar nr 116 dpk, regjistër 2168, datë 13.10.2022 të Zyrës së Përmbarrimit Shkodër, me përfaqësues Taulant Muja. Pavlefshmërinë e urdhërit të ekzekutimit nr 20 datë 28.06.2010 në favor të kreditorit Gjon Mark Shkambi dhe depitorit KKP, Bashkia Shkodër, Ndoc Ndoci, Ndue Pëllumbi, Gjelosh Sufaj etj dhënë për vendimin nr 106 datë 27.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

BAZA LIGJORE:

Nenet 32, 33, 34, 58, 202, 609, 610, 615 K.Pr.Civile.
Nenet 168 dhe 170 të K.Civil.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në prani të palëve, dëgjoi kërkimet e tyre përfundimtare ku paditësit kërkuar pranimin e padisë, palët e paditura rrëzimin e saj, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi

VËREN se

Me datën 21.10.2022 paditësit Gjelo Shufaj, Ndue Pëllumbi dhe Ndoc Ndoci i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë padi me objekt: *"Kundërshtimin e veprimeve përmbartimore të vendimit për ekzekutimin vullnetar nr 116 dpk, rregjistër 2168, datë 13.10.2022 të Zyrës së Përmbartimit Shkodër, me përfaqësues Taulant Muja. Pavlefshmerinë e urdhërit të ekzekutimit nr 20 datë 28.06.2010 në favor të kreditorit Gjon Mark Shkambi dhe depitorit KKP, Bashkia Shkodër, Ndoc Ndoci, Ndue Pëllumbi, Gjelo Shufaj etj dhënë për vendimin nr 106 datë 27.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër."*

Më konkretisht paditësit shpjegojnë se përmbartuesi gjyqësor Taulant Muja ka filluar veprimet për ekzekutimin vullnetar të urdhërit të ekzekutimit me numër 20 datë 28.06.2010 në favor të kreditorit Gjon Mark Shkambi dhe depitorit KKP, Bashkia Shkodër, Ndoc Ndoci, Ndue Pëllumbi, Gjelo Shufaj etj dhënë për vendimin nr 106 datë 27.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Sipas paditësve kryerja e veprimeve për ekzekutimin e këtij urdhëri është në kundërshtim me ligjin dhe me disa vendime gjyqësore për sigurimin e objektit të padisë, të cilat kanë mbetur në fuqi në të tre shkallët e gjykimit. Sigurimi i padisë është bërë me vendimin me numër 7, datë 11.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin me numër 2191, datë 18.11.2013 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënë në fuqi po ashtu edhe nga Gjykata e Lartë për kërkesit Aleksandër dhe Florian Grishaj. Në vendimin e themelit Gjykata me vendimin me numër 1648, datë 08.07.2013 ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

Po kështu edhe në gjykimit me palë Kolë Progni etj nga Gjykata është vendosur pranimi i kërkesëpadisë.

Edhe në gjykimin e padive me palë Ndue Pëllumbi, Ndoc Ndoci, Mark Cilaj etj me vendimin me numër 16, datë 21.02.2013 Gjykata ka vendosur në këtë mënyrë.

Ndodhur në këto kushte shtetasi Gjon Shkami ka paraqitur padi me objekt lirimin dhe kthimin e sendit. Gjykata me vendimin me numër 1751, datë 15.12.2015 ka vendosur pranimin e pjesës së kërkesëpadisë, ku pas ankimit të këtij vendimi Gjykata e Apelit ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim. Në rigjykim paditësi Gjon Shkambi ka kërkuar pushimin e gjykimit pasi do të bënte kallzim, ku në lidhje me këtë kallzim në vijim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kërkesë të prokurorisë, ka vendosur pushimin e hetimeve.

Paditësit pretendojnë se në asnjë vendim gjyqësor nuk ka një disponim nga gjykata që të detyrojë ata të kthejnë sendin dhe në këtë drejtim kjo palë pretendon aplikimin e nenit 451/a, paragrafi i dytë. Mbi këtë argument paditësit kundërshtojnë veprimet përmbartimore si veprime që janë kryer në tejkalim të disponimit gjyqësor.

Paditësit pretendojnë edhe pavlefshmërinë e urdhërit të ekzekutimit me numër 20 datë 28.06.2010 në favor të kreditorit Gjon Mark Shkambi dhe depitorit KKP, Bashkia Shkodër, Ndoc Ndoci, Ndue Pëllumbi, Gjelo Shufaj etj dhënë për vendimin nr 106 datë 27.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në vendimet e mësipërme kanë qenë palë vetëm vetëm shtetasi Gjon Shkambi dhe KKP, Bashkia Shkodër. Po kështu paditësit pretendojnë se janë në mirëbesim.

Paditësit pretendojnë se veprimet e përmbauesit janë në kundërshtim me ligjin pasi pala kërkuese ka paraqitur dokumentacion të dyshimtë dhe gjithashtu veprimet e përmbauesit janë kryer në nxitim e sipër. Përmbauesi ka abuzuar me kompetencat që i janë dhënë në bazë të nenit 521 të K.Pr.Civile.

Bashkalidhur me padinë janë paraqitur këto akte:

- 1) Shkresa me numër 2158 prot, datë 13.10.22 e Zyrës së Përmbaimit Shkodër, "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" drejtuar shtetasve Ndoc Ndoci, Ndue Pëllumbi, Gjelo Shufaj etj. Me anë të kësaj shkrese përmbauesi gjyqësor njofton "personat e tretë" për ekzekutimin vullnetar të vendimit me numër 1158, dt. 05.07.1996 të KKKP, vendimin numër 119, datë 11.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të cilin është lëshuar urdhëri i ekzekutimit nr 20, datë 28.06.2010.
- 2) Shkresa me numër 34 prot, datë 21.01.2013 të Përmbaimit Gjyqësor Privat Martin Tusha, "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" drejtuar shtetasve Gjovalin Shkambi, Mark Markaj, Suzana Vjerdha, Kolë Progni etj. Me anë të kësaj shkrese përmbauesi njofton "personat e tretë" për ekzekutimin vullnetar të vendimit me numër 1158, dt. 05.07.1996 të KKKP, vendimin numër 119, datë 11.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të cilin është lëshuar urdhëri i ekzekutimit nr 20, datë 28.06.2010.
- 3) Vendim me numër 119, datë 11.02.2002 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- 4) Vendimi me numër 1158, dt. 05.07.1996 të KKKP, Bashkia Shkodër.
- 5) Shkurtim vendimi me numër 16, datë 21.02.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me objekt: "Sigurimin e objektit të padisë", me palë kërkuese Ndue Pëllumbi, Ndoc Ndoci dhe Mark Colaj. Në lidhje me këtë kërkesë gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën për sigurimin e objektit të padisë për një afat 6 muaj, duke pezulluar veprimet e përmbauesit gjyqësor Martin Tusha për ekzekutimin e vendimit gjyqësor "Urdhër ekzekutimi" nr 20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, kundrejt pagesës së garancisë monetare prej 20 mijë lekësh për secilin kërkues për një afat 6 muaj.
- 6) Shkurtim vendimi me numër 11, datë 15.02.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me objekt: "Sigurimin e objektit të padisë", me palë kërkuese Kolë Prognaj, Rakip Kurtaj, Gjok Martini etj Në lidhje me këtë kërkesë gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën për sigurimin e objektit të padisë për një afat 6 muaj, duke pezulluar veprimet e përmbauesit gjyqësor Martin Tusha për ekzekutimin e vendimit gjyqësor "Urdhër ekzekutimi" nr 20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër kundrejt pagesës së garancisë monetare prej 20 mijë lekësh për secilin kërkues për një afat 6 muaj.
- 7) Vendim me numër 52, datë 10.06.2013 i Gjykatës së Apelit Shkodër i cili ka lënë në fuqi vendimin me numër numër 11, datë 15.02.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me objekt: "Sigurimin e objektit të padisë".
- 8) Vendim me numër 1648, datë 08.07.2013 me paditës Aleksandër Grishaj, Florian Grishaj, të paditur përmbauesi privat Martin Tushaj dhe Gjon Shkambi, objekt gjykimi

kundërshtim i veprimeve përmbarimore, ku gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës dhe anulimin e të gjitha veprimeve përmbarimore të kryera nga përmbaruesi Martin Tushaj.

- 9) Vendim me numër 1751, datë 15.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me palë: paditës Gjon Shkami, të paditur Mitro Thacina, Kolë Prognaj etj, me objekt "Lirimin dhe kthimin e sendit" dhe kundërpadi "Fitimin e pronësisë me parashkrim fitues..." ku në përfundim gjykata ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, prishur dhe kthyer për rigjykim me vendimin me numër 61, datë 29.01.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe në vijim pushuar me vendimin me numër 196, datë 20.02.2020 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Shkodër.
- 10) Vendim me numër 1942, datë 05.10.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin e hetimeve të procedimit penal me numër 141 të vitit 2015.

Gjykata bazuar në nenet 154, 156 dhe 158/c të K.Pr.Civile ka njoftuar palët për seancën gjyqësor, duke i kërkuar Zyrës së Përmbarimit Shkodër paraqitjen edhe të praktikës përmbarimore.

Me shkresën me numër 116 dpk prot 2733, datë 04.11.2022 nga Zyra Përmbarimore Shkodër është dërguar kjo praktikë sëbashku me një qëndrim të kësaj zyre për kërkesëpadinë. Në lidhje me pretendimet e paditësve Zyra e Përmbarimit Shkodër shprehet se veprimet e ekzekutimit kanë filluar mbi bazën e kërkesës së kreditorit. Veprimet e kryera nga përmbaruesi ligjor janë në përputhje me ligjin dhe mbi këtë bazë kjo palë kërkon rrëzimin e kërkesëpadisë.

Nga praktika e ekzekutimit e dërguar nga Zyra e Përmbarimit Shkodër konstatohen këto akte:

- 1) Kërkesë e datës 22.09.2022 e shtetasit Gjon Shkambi drejtuar Zyrës së Përmbarimit Shkodër për ekzekutim vendimi gjyqësor.
- 2) Vendim me numër 119, datë 11.02.2002 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- 3) Vendimi me numër 1158, dt. 05.07.1996 të KKKP.
- 4) Vendim nr 226, datë 02.06.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, ndryshuar me vendimin nr 20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër.
- 5) Vendim me numër 105, datë 27.03.2002 për ndreqjen e gabimit gjyqësor të vendimit numër 119, datë 11.02.2002.
- 6) Vendim nr 352, datë 22.07.2014 për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vendimin nr 778, datë 27.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- 7) Vendimin nr 778, datë 27.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ku gjykata ka vendosur: *rrëzimin e kërkesës së kërkuësve Kolë Progni etj, heqjen e masës së sigurimit për pezullimin e veprimeve përmbarimore dhënë me vendimet nr 7 datë 07.02.2013 dhe 16, datë 21.02.2013 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin 1073, datë 12.06.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër.*
- 8) Vendim me numër 1068, datë 22.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor privat Martin Tushaj, *ku gjykata ka pranuar padinë e paditëse Mark Colaj, Ndoc Ndoci etj, lënë në fuqi me vendimin me numër 1, datë 07.01. 201 të Gjykatës së Apelit Shkodër.*
- 9) Urdhër rregjistrimi i Zyrës Përmbarimore Shkodër datë 10.10.2022.
- 10) Shkresa me numër 2158 prot, datë 13.10.2022 e Zyrës së Përmbarimit Shkodër, "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" drejtuar shtetasve Ndoc Ndoci, Ndue Pllumbi, Gjelosh Sufaj etj.

- 11) Kërkesë e datës 31.10.2022 e shtetasit Gjon Shkami drejtuar Zyrës Përmbaremore Shkodër për ekzekutimin e vendimit gjyqësor kundër personave të tretë që mbajnë sendin.
- 12) Shkresa me numër 2614 prot, datë 31.10.2022 e Zyrës së Përmbaremit Shkodër, "Kërkesë" drejtuar Komisarariatit të Policisë Shkodër.
- 13) Shkresa me numër 2616 prot, datë 31.10.2022 e Zyrës së Përmbaremit Shkodër, "Kalim në ekzekutimi të detyrueshëm".
- 14) Shkresa me numër 2730 prot, datë 04.11.2022 e Zyrës së Përmbaremit Shkodër, "Kërkesë" drejtuar Komisarariatit të Policisë Shkodër.
- 15) Akte të pronësisë së shtetasit Gjon Shkami.

Gjatë gjykimit përfaqësuesi i paditësve pretendoi se veprimet e kryera nga përmbareuesi gjyqësor Taulant Muja janë të njëjta me veprimet e kryera nga përmbareuesi privat Martin Tusha, për të cilin ka vendime gjyqësore që i kanë konsideruar ato të parregullta. Këto vendime sipas përfaqësuesit të paditësve duhet të merren në konsideratë nga gjykata edhe për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si "gjë e gjykuar".

Gjykata ka pyetur paditësit edhe në lidhje me datën kur janë vënë në dëni të veprimeve të kryera nga përmbareuesi gjyqësor dhe kohën kur ato kanë paraqitur kërkespadi për të kundërshtuar veprimet e tij, ku paditësit kanë bërë të ditur faktin se ata i janë drejtuar gjykatës brenda 4 ditëve nga data kur ka ardhur njoftimi zyrtar, ndërkohë që ata kishin marrë dëni edhe jozyrtarisht edhe më parë. Ndërkohë përmbareuesi gjyqësor Taulant Muja deklaroi se ai ka kryer veprime për verifikimin e objektit ku do të kryhej ekzekutimi.

I padituri Gjon Shkami paraqiti në gjykim kundërpadi, e cila nuk u pranua për shqyrtim nga Gjykata, bazuar në nenin 190 të K.Pr.Civile për shkak të moskonstatimit të lidhjeve të mjaftueshme të saj me padinë në gjykim.

Gjykata pasi shqyroi aktet e paraqitura në gjykim dhe dëgjoi palët, ku paditësit dhe përfaqësuesi i tyre kërkuar pranimin e kërkespadi, të padituri të cilët kërkuar rrëzimin e saj, si dhe pasi vlerësoi dhe bisedoi në tërësi çështjen, cmon se kërkespadi duhet të rrëzohet si e pa bazuar në ligj dhe prova. Ky arsyetim i gjykatës bazohet në këtë arsyetim:

Së pari, Gjykata pasi fillimisht cmon se duhet të vlerësojë kohën e paraqitjes së kërkespadi për kundërshtimin e veprimeve përmbaremore nga paditësit, për të verifikuar nëse kjo padi është paraqitur brenda afatit 5 ditor, sic kërkohet nga neni 610/1 të K.Pr.Civile i cili parashikon:

Kundër veprimeve të përmbareuesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbareuesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit ose refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur, dhe, në raste të tjera, nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin.

Nga të dhënat që rezultojnë nga kërkespadi ajo është depozituar në gjykatë me datën 21.10.2022, ndërkohë që shkresa për "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" i Zyrës së Përmbaremit Shkodër është e datës 13.10.2022.

Po kështu edhe nga shjegimet që përmbaruesi gjyqësor dha përpara gjykatës rezultoi se ai ka kryer veprime verifikuese në objektin ku do të kryhej ekzekutimi, ku përmes këtij veprimi paditësit janë vënë në dijeni të veprimeve të ekzekutimit të zyrës së përmbarrimit. Bazuar në këto rrethana rezultoi qartë që nga ana e paditësve nuk është respektuar afati 5 ditor i përcaktuar në këtë dispozitë për kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore.

Së dyti, Gjykata gjen me vend të trajtojë edhe pretendimet e palës paditëse se veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor Taulant Muja janë të njëjta me veprimet e kryera nga përmbaruesi privat Martin Tushaj, për të cilat ka vendime gjyqësore që i ka konsideruar këto veprime si të parregullta, pra pretendimin e kësaj pale se ato përbëjnë gjë të gjykuar.

Nëse i referohemi neni 451/a të K.Pr.Civile evidentohet qartë që parimi i “gjësë së gjykuar” kërkon disa kushte që janë: Palët në gjykim të jenë të njëjta dhe objekti dhe shkaku i padisë të jetë i njëjtë.

Kështu në këtë dispozitë parashikohet: *Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.*

Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohej përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Nëse i referohemi vendimeve për të cilat pala paditëse pretendon zbatimin e parimit “gjë e gjykuar” Gjykata eidenton faktin se këto vendime jo vetëm që nuk janë më në fuqi, pasi janë cënuar me vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër¹, por edhe sikur të pranohet e kundërta këto vendime nuk ndodhen në rrethanat e kërkuara nga neni 451/a të K.Pr.Civile.

Kjo për shkak se forma me të cilën palët i janë drejtuar gjykatës ndryshon në secilin gjykim (ku i pari është kërkesë dhe tjetri kërkesëpadi). Po kështu palët pjesmarrëse në gjykim ndryshojnë. Mbi këtë bazë Gjykata vlerëson se vendimet e marra nga Gjykatat në lidhje me veprimet e përmbaruesit gjyqësor privat Martin Tushaj nuk mund të sjellin efekt mbi veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor Taulant Muja, për shkak se vendimet e para kanë efekt vetëm për ato palë pjesmarrëse në gjykim dhe për sa kohë përmbaruesi gjyqësor, veprimet e të cilit vlerësohen në këtë gjykim nuk ka qenë palë në gjykimet e mëparshme, këto vendime gjyqësore nuk janë detyruese për të.

Së treti, në lidhje me pretendimin e paditësve se nuk ka asnjë vendim gjyqësor që të këtë përcaktuar detyrime për ata për shkak se vendimet gjyqësore të vëna në ekzekutim kanë palë: kreditor Gjon Shkami dhe debitor KKKP Bashkia Shkodër, Gjykata vlerëson se ky qëndrim është tërësisht i gabuar.

Kjo për shkak se paditësit janë posedues të paligjshëm të pasurive, të cilët krahas të tjerash rezultojnë t'i mbajnë këto pasurime dhunë apo forcë. Kjo formë e posedimit të pasurisë nuk gëzojnë asnjë mbrojtje ligjore, aq më pak përkundëjt pretendimeve të pronarit të pasurisë. Në nenin 312/3

¹ Vendim me numer 1068, datë 22.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor privat Martin Tushaj, ku gjykata ka pranuar padinë e paditëse Mark Colaj, Ndoc Ndoci etj, lënë në fuqi me vendimin me numër 1, datë 07.01.201 të Gjykatës së Apelit Shkodër

të K.Civil parashikohet: "Pushimi i cenimit të posedimit nuk mund të kërkohej nga personi që ka fituar posedimin me dhunë ose fshehurazi."

Nëse Gjykata do të mbante një qëndrim të kundërt kjo do të çenonte të drejtat që ligji i njeh pronarit të pasurisë për "të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji." Në asnjë rast nuk mund të pranohet që poseduesi i pasurisë ka të drejta mbi pronën më shumë se të drejtat që vetë ligji i njeh pronarit të saj. Jo pa shkak në nenin 296 të K.Civil parashikohet se "Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës."

Në të njëjtën linjë llogjike ligjvënësi në nenin 521 të K.Pr.Civile ka parashikuar rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor kur sendi mbi të cilën kryhet ekzekutimi mbahet nga të tretët. Kështu në këtë dispozitë parashikohet:

"Urdhri i ekzekutimit kundër debitorit mund të vihet në ekzekutim edhe kundër personit të tretë, që për sigurimin e detyrimit ka ngarkuar me barrë sipas ligjit një send të tij, kur kreditori kërkon ekzekutimin mbi këtë send."

Në rastin konkret rezulton qartë se ka qenë pikërisht kreditori Gjon Shkambi i cili i ka paraqitur përmbaruesit gjyqësor kërkesë për kthimin e sendit të mbajtur nga personat e tretë.

Bazuar në këtë arsyetim Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësve për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor mbi këtë shkak nuk përbëjnë shkak të ligjshëm për ti bërë veprimet e këtij të fundit të parregullta dhe të paligjshme.

Së katërti, Gjykata vlerëson si të pabazuar edhe pretendimin e paditësve për pavlefshmerinë e urdhërit të ekzekutimit me numër 20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër. Nga aktet e sipërcituara ky titull ekzekutiv rezulton nga një vendim gjyqësor i formës së prerë² (dërguar me praktikën e ekzekutimit të përmbaruesit gjyqësor), vendim i cili është i detyrueshëm për zbatim bazuar në nenin 451/a të K.Pr.Civile.

Në nenin 510 të K.Pr.Civile parashikohet:

Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim,
.....

Gjykata e Apelit Shkodër në pjesën përshkruese-arsyetuese të këtij vendimi shprehet: "Arsyetimi i gjykatës së ky vendim nuk përmban detyrim për palët por kërkuar i është njohur një e drejtë e për rrjedhojë smund të lëshohet urdhër për ekzekutimin e tij është keqinterpretim i ligjit jo vetëm për faktin se dispozita nuk kërkon detyrim por edhe sikur ti jetë njohur kërkuar i është njohur një e drejtë ajo realizohet përmes urdhërit të ekzekutimit sic është e drejta e parablerjes....."

Përfundimisht Gjykata nuk konstaton veprime të kryera në kundërshtim me parashikimet ligjore nga ana e përmbaruesit gjyqësor dhe po kështu cmon se titulli ekzekutiv i vënë në ekzekutim përmes veprimeve të përmbaruesit gjyqësor nuk është i pavlefshëm. Mbi këtë shkak cmohet se kërkesëpadia objekt gjykimi duhet të rrëzohet si e pa bazuar në ligj dhe prova.

² Vendim nr 226, datë 02.06.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, ndryshuar me vendimin nr 20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër

PËR KËTO ARSYE


Gjykata, bazuar në nenet 521, 610 dhe 306 të K.Pr.Civile;

VENDOSI


1. Rrëzimin e kërkespadi së.
2. Shpenzimet gjyqësore mbeten sic janë bërë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i vecantë në Gjykatën e Apelit Shkodër, brenda afatit ligjor, afat që fillon nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Shkodër, sot me datën 24.11.2022.

Sekretare
Mirsada Kastrati



Gjyqtar
Andri Ymeri



VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRE FORME TE PARE

ME DATE

30.01.2023

SECRETARAT

SINCLA

